



- Të Reja ▾ Policia e Shtetit ▾ Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptar Shërbime ▾ Baza ligjore Vendndodhjet e policisë Video
- Programi i transparencës ▾ Kontakt Denonco Krimin Kibernetik Drejtoritë Vendore të Policisë ▾ Policia Kufitare ▾ Policia Rrugore ▾
- Donacione Rubrika Policimi në Komunitet ▾ Përmbledhja Javore Për sinjalizimin

Breaking News: Durrës – Aksidentoi një këmbësor, me pasojë vdekjen, arrestohet në flagrancë 19-vjeçari
Tiranë – Finalizohet nga Komisariati i Policisë Nr. 1, operacioni policor i koduar “Brylli”
Muriqan – Finalizohet operacioni policor i koduar “Moscow”
Gjiri i Sarandës – Mbetën në det, pasi veliera pësoi defekt, Policia iu shkon në ndihmë 3 shtetasve
DVP Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “The wanted”



28/08/2023

Tiranë – Finalizohet Nga Komisariati I Policisë Nr. 1, Operacioni Policor I Koduar “Brylli”

Tiranë

Finalizohet nga Komisariati i Policisë Nr. 1, operacioni policor i koduar “Brylli”, për goditjen e veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve dhe të armëmbajtjes pa leje.

Posedonte droga të forta, armë zjarri, armë të ftohta dhe sende të kundërligjshme, në automjet dhe në banesë, arrestohet në flagrancë 40-vjeçari.

Sekuestrohen sasi të lëndëve narkotike kokainë dhe heroinë, 1 armë zjarri pistoletë, 1 pushkë pneumatike, 1 palë dylbi, 1 dorezë me mekanizëm si pistoletë për të realizuar qitje, 1 shënjestër optike, 2 armë të ftohta (thika) dhe municion luftarak.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 1, në zbatim të planit të masave për kapjen e shtetasve në kërkim dhe të atyre që qarkullojnë me sende të kundërligjshme, bazuar dhe në informacionet e siguruara nga intelijenca informative, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar “Brylli”.

Si rezultat u bë arrestimi i shtetasit G. H., 40 vjeç, banues në Tiranë.

Në bulevardin “Bajram Curri”, shërbimet e Policisë kanë ndaluar për kontroll automjetin me drejtues shtetasin G. H., në të cilin kanë gjetur dhe sekuestruar sasi të lëndëve të dyshuara narkotike kokainë dhe heroinë, 1 thikë dhe 1 palë dylbi.

Në vijim të veprimeve, gjatë kontrollit në banesën e këtij shtetasi, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan 1 pushkë pneumatike, 1 armë zjarri pistoletë, 1 dorezë me mekanizëm si pistoletë për të realizuar qitje, 1 shënjestër optike, 1 thikë dhe municion luftarak.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme.



◀ Muriqan – Finalizohet operacioni policor i koduar “Moscow”

Durrës – Aksidentoi një këmbësor, me pasojë vdekjen, arrestohet në flagrancë 19-vjeçari ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)